



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI**

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

**Dokument Parlamentar**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

**Tiranë, më 27.06.2023**

**RAPORT PËR SHQYRTIMIN E RAPORTIT VJETOR PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËROR PËR VITIN 2022 DHE MIRATIMIN E PROJEKTREZOLUTËS PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR PËR VITIN 2023**

Komisioni Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjet e zhvilluara në datat 16 dhe 27 Qershor 2023, mori në shqyrtim raportin vjetor të punës së Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2022 si dhe projekt –rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2022”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në zbatim të nenit 82, të ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, ka paraqitur raportin vjetor për punën e tij për vitin 2022, pranë Kuvendit të Shqipërisë.

Në mbledhjen e datës 16 Qershor 2023, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, bazuar në nenin 103 pika 2 të Rregullores së Kuvendit, organizoi seancë dëgjimore me znj. Naureda Llagami, Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor gjatë prezantimit të raportit në mbledhje, theksoi se rrugëtimi i Këshillit ka qënë i mbushur me sfida të qënësishme me qëllim arritjen e menaxhimit të një sistemi gjyqësor sa më të pavarur dhe eficient, për të garantuar drejtësi efikase dhe pa vonesa për qytetarët.

Raporti vjetor pasqyron veprimtarinë vjetore të KLGJ-së duke paraqitur gjithashtu dhe një përshkrim analitik të detajuar të situatës dhe funksionimit të sistemit gjyqësor.

Zonja Llagami, referoi se veprimtaria e Këshillit është fokusuar në pikat nevralgjike të sistemit, të cilat kishin nevojë për vëmendje të shtuar.

Prioritet kryesor i Këshillit edhe gjatë vitit 2022, ka qënë përmbyllja në një kohë sa më të shpejtë e procedurave për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë si dhe plotësimi i vendeve vakante në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Konsolidimi i kapaciteteve të sistemit gjyqësor mbetet gjithashtu një prioritet i Këshillit në vijimësi, i cili është konkretizuar me punë voluminoze dhe intensive.

Më qëllim rritjen e efencës në sistemin gjyqësor Këshilli ka vijuar zbatimin e reformës së administratës civile gjyqësore me qëllim garantimin e profesionalizimit, qëndrueshmërisë dhe integritetit në ushtrimin e funksioneve publike.

Këshilli është angazhuar gjithashtu edhe në drejtim të forcimit të kapaciteteve administrative në sistemin gjyqësor si dhe në plotësimin e akteve nënligjore sa i takon vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve.

Znj Llagami gjithashtu bëri një prezantim të hapave të ndërrmarë sa i takon zbatimin të VKM nr. 495, datë 21.7.2022 “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave” duke sqaruar se deri në fund të vitit 2022, Këshilli ka miratuar aktet nënligjore për të bërë të mundur zbatimin në praktikë të hartës së re gjyqësore në vitin 2023.

Gjithashtu, Zonja Llagami në përmbyllje të prezantimit parashtrori në hollësi dhe analizen e kryer nga Këshilli mbi situatën e gjykatave duke theksuar se qëllim i kësaj analize është matja dhe interpretimi i treguesve të performancës së gjyqësorit me synim evidentimin e nevojave për përmirësimin e punës dhe ofrimin e një drejtësie cilësore dhe pa vonesa për qytetarët.

Pas përfundimit të prezantimit të raportit vjetor, relatori i çështjes, i caktuar nga komisioni Z. Damian Gjikhuri parashtrori mendimin e tij mbi raportin duke evidentuar vlerësimet dhe problematikat për veprimtarinë e KLGJ-së gjatë vitit 2022.

Pas prezantimit të mendimit të relatorit të çështjes, seanca dëgjimore vijoi me një sërë pyetjesh të deputetëve, drejtuar Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbi veprimtarinë e institucionit për vitin 2022.

Në mbledhjen e datës 27 Qershor 2022, në Komision u diskutua dhe për projekt-rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2022”. Komisioni me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, miratoi projekt-rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vitin 2022”, sipas propozimit të relatorit, duke pasqyruar në versionin final edhe sugjerimet konsultuar me institucionin me qëllim paraqitjen për votim seancës plenare të Kuvendit të Shqipërisë.

Bashkëlidhur teksti integral i Projekt-Rezolutës.

**RELATOR**

**Damian GJIKNURI**

**KRYETARE**

**Klotilda BUSHKA**